

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	TASK FORCE - Elhame Hetimi: Në Hagë u gjykuan krerët e UÇK-së dhe shtetit, procesi ka krijuar dyshi me për drejtësinë
ADRESA	https://www.syri.net/politike/917148/elhame-hetimi-ne-hage-u-gjykuan-kreret-e-uck-se-dhe-shtetit-procesi-ka-krijuar-dyshime-per-drejtesine/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 16:23:57 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 15:53:45 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c68fd2d2d91563053bb7cfe8740fe44f7696c1e8cab815bfc3961239329df5d97
TEKSTI	1aaf45bdb5234fe9426fde11977494f5b11418de2b6c0b592bbc7fdb586a9cb2
PAMJA	d28a39fbfaf3e0635ce29ad60ac4143a6124385eef2f203c88b706e482bfa0c7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d4d13d05f2df1fd4c534af0fdd82c321a1be6b6104b1f6982c722009e628a506
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	6d78d2dc60f31cde5fa6ff278c9155b75ea76fff53014b2b93764708aa00c94f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d4d13d05f2df1fd4c534af0fdd82c321a1be6b6104b1f6982c722009e628a506>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



ÇIM PEKA

Tradhtia që s'e panë tu ardhë



NDRIM KULLA

Gjuha si brushë dhe ironia si armë e Edi Ramës

LAJMI I FUNDIT

LIVE/ Kuvendi i Partisë Demokratike, Dega Krujë, merr pjesë kreu i PD, Sali Berisha

më të lexuarat

Zhupa: Nga shkollat me turne te emigrimi i të rinjve, problemet mbeten të njëjta, fëmijët paguajnë çmimin


Specialja: Të akuzuarit vepruan së bashku për një qëllim të përbashkët kriminal, Thaçi ishte anëtar kyç

'Mafia emëron ministrat në qeverinë Rama', Kepi: E kanë të lehtë të gjejnë personin e duhur për aferat e tyre

'Thaçi kishte dijeni për krimet, Veseli mori pjesë dhe inkurajoi kryerjen e tyre'

Muzeu hebraik në Vlorë/ Nezini: Godina i përket Klubit Labëria, po zhduket historia

PD: Shpopullimi i Shqipërisë, një krizë që po zbraz vendin dhe po rrezikon të ardhmen e tij



Elhame Hetimi: Në Hagë u gjykuan krerët e UÇK-së dhe shtetit, procesi ka krijuar dyshime për drejtësinë

17:53, 16/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



E ftuar në emisionin "Task Force" me Sonila Meçon në Syri TV, Elhame Hetimi, ish-ushtare e UÇK-së, foli për proceset gjyqësore ndaj ish-drejtimesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Hagë.

Hetimi deklaroi se, pavarësisht qëndrimeve se proceset nuk prekin luftën e UÇK-së apo shtetin e Kosovës, në bankën e të akuzuarve ndodhen figura që kanë drejtuar UÇK-në dhe institucionet e Kosovës.

Ajo tha se mënyra e zhvillimit të procesit ka krijuar "shumë parregullsi" dhe dilema, duke ngritur dyshime mbi drejtësinë dhe vetë gjykatën.

Hetimi pretendoi gjithashtu se gjatë kohës së paraburgimit janë ngritur akuza të tjera, përtej akuzave për të cilat të pandehurit ishin marrë fillimisht në paraburgim.

Duke folur për krijimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës, Hetimi tha se formimi i kësaj gjykate u pranua dhe u votua nga institucionet e Kosovës në kushtet e një presioni të madh ndërkombëtar.

Sipas saj, institucionet e Kosovës u përballën me paralajmërime se çështja mund të kalonte në një tjetër stad në kuadër të OKB-së.

Ish-ushtarja e UÇK-së e lidhi procesin në Hagë edhe me një dimension politik e kombëtar, duke argumentuar se gjykimi ka prekur jo vetëm individët e akuzuar, por edhe dinjitetin kombëtar shqiptar dhe perceptimin mbi luftën e UÇK-së.

Ajo kritikoi në veçanti pretendimet fillestare për një "ndërmarrje të përbashkët kriminale", të cilat i konsideroi të pabazuara.

Pjesë nga intervista:



Po, e dëgjova edhe fjalën përfundimtare të Gjykatës. Pavarësisht që deklarativisht thuhet se nuk është prekur lufta e UÇK-së, nuk është

prekur shteti i Kosovës, në fakt nuk mund të na shpërqendrojnë nga ajo se në ato bankat e të akuzuarve janë kreu i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe kreu i shtetit. Të gjithë ata kanë shkuar si personalitete shtetërore, president, kryetar kuvendi dhe deputet i Republikës së Kosovës. Në fakt akuzat e ngritura dhe të iniciuara kanë qenë si ndërmarrje e përbashkët kriminale, të iniciuara nga Dick Marty, dhe më vonë të faktuara se nuk qëndrojnë. Ka pasur shumë parregullsi edhe drejt dilemat që neve na kanë bërë akoma më të paqartë dhe të dyshojmë shumë në këtë drejtësi dhe në këtë gjykatë. Kur janë marrë në paraburgim për një akuzë të caktuar, ndërsa gjatë kohës sa mbaheshin për atë akuzë kanë ngritur një aktakuzë tjetër të paparashikuar dhe të panjohur neve si opinion, si qytetarë, dhe vetë ata për të cilët janë mbajtur peng në paraburgim për një akuzë krejt tjetër.

Po gjykohen të gjitha! Ata kanë prekur në qenien shqiptare. Ata kanë prekur në dinjitetin kombëtar, jo vetëm të Kosovës dhe shqiptarëve në Kosovë, kanë prekur në dinjitetin e secilit shqiptar. Kanë prekur në të tashmen, kanë prekur në të ardhmen e kombit shqiptar.

Edhe vetë formimi i kësaj gjykate, që ka qenë krejt diçka e re, hibride, e paparë ndonjëherë, domethënë ka qenë e panjohur edhe për vetë krerët e shtetit të Kosovës të cilët e kanë ditur që janë edhe të akuzuar. Domethënë, presioni ndërkombëtar dhe barra e përgjegjësisë së shtetit të Kosovës, po edhe vetë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i shtyri me e pranuar formimin e saj, me e votu formimin e saj. Presioni i madh se do të kalonte në një stad tjetër të OKB-së si gjykatë e të tjera. Domethënë ramë, ndoshta kemi rënë përgjithësisht dhe kemi besuar... duke besuar në pastërtinë e luftës së drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ndoshta kemi rënë në lajthitjen e thikës pas shpine që na u bë nga eksponentë të caktuar dashakeqës dhe kundërshtarë të lirisë dhe të pavarësisë.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Vendimi i Hagës/ Gjokutaj: Ajo gjykatë u krijuar nga antishqiptarët, dhe sigurisht që do të prodhonte antishqiptarizëm



VIDEO/ Zaimi: Vendimi i Hagës është i papranueshëm, qytetarët prisnin lirinë e ish-krerëve të UÇK-së



Policia holandeze për protestat në Hagë: Dy të arrestuar dhe një polic i lënduar

Urimi dhe mesazhi i Metës: PISA janë një tjetër dëshmi e gjendjes alarmante të shkollave! Për PL-në arsimit prioritet

'Selimi dha kontribut në zbatimin e qëllimit të përbashkët kriminal, mori pjesë në kryerjen e krimeve'

Ngërçi me pagat/ Gjykata e Kukësit mbyll dyert për qytetarët 3 ditë

TË NGJASHME



Dënimi i 4 ish-krerëve të UÇK-së, reagon Kroacia: Kosova ishte viktimë e krimeve të Millosheviçit



Djali i Jakup Krasniqit reagon pas verdiktit të Hagës: UÇK-ja është dhe do të mbetet krenaria jonë



Detajet e verdiktit për ish-krerët e UÇK-së: Çka konstatoi trupi gjygues?



Britania për dënimin e ish liderëve të UÇK: Vendimi nuk duhet të përdoret për të nxitur tensione



Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë shpreh shqetësim të thellë për vendimin e Dhomave të Specializuara në Hagë



Protestuesit gjuajnë me gurë ndërtesën e Qeverisë së Kosovës



SYRI TV/ Vendimi i Hagës, reagime në Shqipëri, Berisha: Vendimi ishte i pamërituar - Meta: Ditë e trishtuar për të gjithë



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.